

12 gushti – Dita Botërore e të Rinjve

GJENDJA SHËNDETËSORE DHE MBROJTJA SHËNDETËSORE E FËMIJËVE TË MOSHAVE SHKOLLORE DHE TË RINJVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, 2023


Veprimtaria e mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve realizohet në 36 pikë, me ç'rast të gjitha ndodhen në qytete.

Në këtë veprimtari punojnë 43 mjekë dhe 71 punonjës shëndetësorë me përgatitje të lartë dhe të mesme profesionale. Nuk është arritur standard i kënaqshëm sa i përket sigurimit të mjekëve për këtë grup të popullatës, pra në Republikën e Maqedonisë së Veriut në 6262 fëmijë të moshës nga 7-19 vjet ka nga 1 mjek.

Nuk është i kënaqshëm edhe raporti mes mjekëve dhe punonjësve shëndetësorë me përgatitje të lartë dhe të mesme profesionale i cili aktualisht është 1:2

Vëllimi i përgjithshëm i shërbimeve shëndetësore preventive dhe i aktiviteteve të realizuara në vitin 2023 shënon një **rritje prej 11.4** pikë të indeksit krahasuar me vitin 2022. Diagrami 1

Diagrami 1




Burimi: ISHPRMV - Raporti i Shërbimit për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve, 2022 dhe 2023

Vëllimi i përgjithshëm shërbimeve dhe aktiviteteve shëndetësore kurative të realizuara në vitin 2023 shënon një rritje prej 12.4 pikë të indeksit krahasuar me vitin 2022. Është rritur numri i vizitave në ordinancë tek mjeku për 13,5 pikë të indeksit në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022. Ka rënë numri i vizitave tek punonjësit shëndetësorë me përgatitje të lartë dhe të mesme profesionale në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022. Ka rënë numri i vizitave tek psikologu dhe logopedi për 82.2 pikë të indeksit në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

Diagrami 2

Diagrami 2



Burimi: ISHPRMV - *Raporti i Shërbimit për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve, 2022 dhe 2023*

Morbiditeti i regjistruar në veprimtarinë e mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve, 2022

Në veprimtarinë e mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve në vitin 2022 janë regjistruar gjithsej 562781 sëmundje që është për 5.2% më shumë se sa një vit më parë (535009-2021)

Grupet e sëmundjeve dhe gjendjet shëndetësore	Numri	MB‰‰	%
GJITHSEJ	562781	14743.2	100.0
Sëmundje infektive dhe parazitare	37152	973,3	6,6
Neoplazma	1546	40,5	0,3

Sëmundje të gjakut dhe organeve gjeneruese të gjakut dhe sëmundje të mekanizmit imunitar	5521	144,6	1,0
Sëmundje endokrine, nutritive dhe metabolike	6356	166,5	1,1
Çrregullime mendore dhe çrregullime të sjelljes	7598	199,0	1,4
Sëmundje të sistemit nervor	5879	154,0	1,0
Sëmundje të syrit dhe adnekseve	14278	374,0	2,5
Sëmundje të veshit dhe zgjatimit mastoid	13986	366,4	2,5
Sëmundje të sistemit të qarkullimit	2439	63,9	0,4
Sëmundje të sistemit respirator	225299	5902,1	40,0
Sëmundje të sistemit digjestiv	22719	595,2	4,0
Sëmundje të lëkurës dhe indit nënlëkuror	28853	755,9	5,1
Sëmundje të sistemit muskulo-skeletor	14192	371,8	2,5
Sëmundje të sistemit urogjenital	13613	356,6	2,4
Shtatzëni, lindje dhe puerperium	131	3,4	0,0
Malformacione kongjenitale, deformitete dhe anomali kromozomale	1753	45,9	0,3
Simptoma, shenja dhe pasqyra klinike dhe rezultate laboratorike jonormale	51252	1342,6	9,1
Lëndime, helmime dhe pasoja të tjera nga faktorë të jashtëm	15990	418,9	2,8
Faktorë që ndikojnë në gjendjen shëndetësore dhe kontaktet me shërbimet shëndetësore	94224	2468,4	16,7


Burimi: ISHPRMV - Raporti i Shërbimit për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve, 2022

Në strukturën e grupeve të veçanta të sëmundjeve, **sëmundjet respiratore sërish janë në vendin e parë** me një pjesëmarrje prej 40% në numrin e përgjithshëm dhe shkallë prej 5902,1‰.

Në vendin e dytë janë sëmundje të caktuara infektive dhe parazitare me një pjesëmarrje prej 6,6% dhe shkallë prej 973.3‰; në vendin e tretë janë sëmundjet e lëkurës dhe indit nënlëkuror me një pjesëmarrje prej 5.1% dhe shkallë prej 755.9‰; në vendin e katërt janë sëmundjet e sistemit digjestiv me një pjesëmarrje prej 4% dhe shkallë prej 595.2‰; në vendin e pestë janë sëmundjet e syrit dhe adnekseve me një pjesëmarrje prej 2,5% dhe shkallë prej 374‰ etj.


Diagrami 2 dhe 3

Diagrami 3



Burimi: ISHPRMV - Raporti i Shërbimit për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollë dhe të rinjve, 2022

Diagrami 4



Burimi: ISHPRMV - Raporti i Shërbimit për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollë dhe të rinjve, 2022

Mortaliteti i regjistruar në veprimtarinë e mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollë dhe të rinjve

Në vitin 2022 janë regjistruar gjithsej 99 persona të vdekur në moshë nga 5-24 vjet dhe një shkallë e mortalitetit prej 20.3‰.

Mortaliteti sipas moshës dhe gjinisë, 5-24,RMV,2022 (Shkalla/100000)

	Gjithsej		5-9 vjet		10-14 vjet		15-24 vjet	
	Numri	Shkalla	Numri	Shkalla	Numri	Shkalla	Numri	Shkalla
Gjithsej	99	20,3	7	6,0	15	13,3	77	29,6
Meshkuj	67	26,6	3	5,0	10	17,3	54	40,3
Femra	32	13,5	4	7,2	5	9,2	23	18,3

Burimi: Lëvizja natyrore e popullisë,2022

Shpërndarja sipas moshës tregon se të rinjtë në moshë nga 15-24 janë më të përfaqësuar në mortalitetin e përgjithshëm të kësaj popullate dhe atë me 77,8% dhe një shkallë prej 29,6‰.

Shpërndarja sipas gjinisë tregon se meshkujt janë më të përfaqësuar në mortalitetin e përgjithshëm, se sa femrat.

Rekomandime:

- ngritja e vetëdijes tek të rinjtë përmes programeve për edukim shëndetësor në të gjitha nivelet për ta theksuar rëndësinë e shëndetit dhe mirëqenies së tyre të përgjithshme;
- pjesëmarrje aktive në implementimin e programeve shëndetësore me qëllim të zbatimit të njohurive të marra nëpërmjet edukimit shëndetësor për një mënyrë të shëndetshme të jetesës;
- ngritja e vetëdijes tek të rinjtë për rrezikun që ekziston ndaj shëndetit të tyre për t'i reduktuar sjelljet e rrezikshme.

LITERATURA

1. Enti Shtetëror i Statistikave. Lëvizja natyrore e popullsisë në RMV, 2022. Shkup, qershor, 2023
2. Instituti i Shëndetit Publik i RMV-së. Raporte vjetore dhe gjashtëmujore nga Shërbimet për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve të moshave shkollore dhe të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2022. Shkup, qershor, 2023

Përgatiti: Departamenti për Promovimin e Shëndetit dhe Ndjekjen e Sëmundjeve